

Hajri Shehu

**Për ligjërimin bisedor e krahinor në gjuhën shqipe
dhe shenjimin leksikografik *bised*.**

Përmbledhje


Ligjërimi bisedor është gjuha e gjallë e përbashkët kombëtare. Vendi i tij është midis gjuhës standarde dhe dialekteve (të folmeve). Dhe kjo do të thotë, atëherë, që ai është gjithnjë nën ndikimin edhe të gjuhës standarde, edhe të ligjërimin dialektor-krahinor. Ndikon më shumë gjuha standarde apo ligjërimi dialektor-krahinor, varet nga një varg faktorësh. Por, sot është gjithnjë e më shumë nën ndikimin e gjuhës standarde – të shkruar dhe të folur. Dhe kjo do të thotë që ka edhe një nivel tjetër të ligjërimin bisedor: Është niveli kohësor. Atëherë, të gjitha nivelet e ligjërimin bisedor – fonetik / morfologjik / leksikor / sintaksor etj. duhen parë në kohë e sipas kohës.

Vijmë tek trajtimi leksikografik i leksikut, që na e sjell ligjërimi bisedor. Cilat nga njësitë ligjërimore bisedore e bisedore-krahinore mund të përfshiheshin në një fjalor kombëtar të gjuhës shqipe dhe cilat mund të shenjoheshin me shënimin leksikografik *bised*?


Më poshtë shtjellohet trajtimi leksikografik i leksikut, që na e sjell ligjërimi bisedor.

Fjalë kyçe: *Ligjërim bisedor, gjuhë bisedore, leksik me vlerë letrare potenciale, shenjim leksikografik, fjalë të përdorimit të përgjithshëm, fjalë të përdorimit të kufizuar, leksik bisedor profesional, ligjërim i thjeshtë.*


Ligjërimi bisedor është gjuha e gjallë e përbashkët kombëtare. Vendi i tij është si më poshtë:




Sipas skemës së parë, mund të shkojmë te një skemë e dytë:



Fjalët me përdorim të kufizuar janë te ligjërimi bisedor dhe tek të folmet krahinore. Dhe, po të bëjmë veçime të tjera, pas skemës së dytë mund të shkojmë te një siskemë e tretë:




Dhe te një siskemë e katërt:



E zgjeruar, e tërë skema e parë është:

¹ Siç dihet e siç shihet nga skema, gjuha bisedore është koncept më i gjerë se ligjërimi bisedor. Gjuha bisedore e përfshin ligjërimin bisedor. Ne duam të merremi me ligjërimin bisedor.



Sipas skemës së parë (aty janë format themelore të gjuhës shqipe), ligjërimi bisedor zë vend ndërmjet gjuhës standarde dhe të folmeve krahinore. Dhe kjo do të thotë që ai është gjithnjë nën ndikimin edhe të gjuhës standarde, edhe të ligjëritit dialektor-krahinor. Ndikon më shumë gjuha standarde apo ligjërimi dialektor-krahinor, varet nga një varg faktorësh: nga etapa e zhvillimit të gjuhës standarde, nga statusi i të folmeve dialektore-krahinore, nga formimi shkollor e intelektual e gjuhësor i folësve², nga zhvillimi i përgjithshëm shoqëror (p.sh., urbanizimi) etj.³

Ligjërimi bisedor është gjuha e gjallë. Dhe prandaj, tek ai ndryshojnë vazhdimisht mjetet e shprehjes. Dhe prandaj ai ndryshon nga norma letrare e gjuhës standarde, e cila është sistem shumë i qëndrueshëm, shumë më i pandryshueshëm. Por me ndikimin gjithnjë e më shumë të gjuhës standarde, zgjerohet rrethi i folësve që e kanë letrar ligjërimin e tyre bisedor. Ligjërimi i sotëm bisedor (letrar) përdallon edhe nga koineja bisedore e periudhës parakombëtare të gjuhës shqipe. Përse? Sepse, siç u tha, ai është nën ndikimin rregullues normativizues të gjuhës standarde – të shkruar dhe të folur. Dhe kjo do të thotë që ka edhe një nivel tjetër të ligjëritit bisedor: Është niveli kohësor. Atëherë, të gjitha nivelet e ligjëritit bisedor – fonetik / morfologjik / leksikor / sintaksor etj. duhen parë në kohë e sipas kohës.⁴

Meqë tani, siç u tha, zgjerohet rrethi i folësve që e kanë letrar ligjërimin e tyre bisedor, letërsia artistike e përcjell atë më tej. Dhe, kësajsoj, letërsia

² Për shembull, një folës i formuar shkollarisht e ka më të lehtë që sipas situatave ligjërimore, ta përndryshojë regjistrin e ligjëritit.

³ Kur themi nga gjuha standarde, kemi parasysh më shumë gjuhën e folur standarde (gjuhën e radiove, të televizioneve, të fjalimeve, të tryezave televizive etj.), sepse si formë e folur (e gjuhës), është vijimisht më afër veshit të dëgjuesit (njëherësh – edhe folës).

⁴ Dhe, po kështu, edhe shënjimi leksikografik në fjalorët e shqipes.

artistike na e jep një mundësi edhe për ta njohur dhe për ta vjelë atë dhe më shumë se kaq, edhe për të zgjedhur leksikografikisht njësi leksikore, frazeologjike etj. nga ligjërimi bisedor. Veç kësaj, në letërsinë artistike, ligjërimi bisedor stilizohet me mjete të gjuhës letrare të shkrimtarit.⁵ Atëherë, edhe te ligjërimi bisedor mund të kërkojmë normën letrare. Te cili lloj i ligjërimi bisedor? Siç shihet nga skema e parë, te ligjërimi bisedor letrar, që vjen kryesisht nga letërsia. Më së shumti:

a) Nga letërsia dramaturgjike e humoristike (sepse ajo sjell lëndë bisedore autentike)⁶.

b) Nga proza e shkurtër tregimtare: mite, legjenda, gojëdhëna, fabula, anekdota etj.⁷

c) Nga krijimtaria gojore popullore, sidomos, nga poezia lirike popullore. Kjo krijimtari njihet nga shumë folës, çka do të thotë:

1. Historikisht, në tërësi, gjuha e saj “është e miratuar” në gjuhën e letërsisë artistike.⁸

2. Për arsye të kohezionit të sotëm shoqëror, mjaft shpesh, poezia e sotme popullore ka gjuhë mbidialektore e mbikrahinore.⁹

3. Për arsye të bashkëmarrëdhënieve të krijimtarisë gojore popullore me letërsinë artistike, mjaft tematika folklorike hyjnë në orbitën e letërsisë artistike e kësajsoj përpunohen thellë. Përpunohen thellë me gjuhën letrare të letërsisë artistike.¹⁰

4. Folklori ka ndikuar e ndikon në letërsi me stilin realist të tregimit. Dhe këto ndikime te gjuha e letërsisë na çojnë.

ç) Edhe nga frazeologjia popullore. Frazeologjia është veçori e ligjërimin bisedor. Në ligjërimin bisedor, siç u tha, ndryshojnë vazhdimisht mjetet e

⁵ Sigurisht, kjo varet nga stili individual i shkrimtarit, nga pëlqimet e mospëlqimet e tij, nga kërkesat e kohës etj.

⁶ Na duket se gjuhësisht, kjo lloj letërsie është studiuar pak.

⁷ Edhe tek anekdotat, baza emocionale është komizmi.

⁸ «Folklori gojor paraqitet në këtë rast, jo vetëm si fushë e veprimit të leksikut popullor, por edhe si fushë verifikimi e vlerave të këtij leksiku, si vatër e përpunimit të tij të mëtejshëm”. Jani Thomai, *Rreth leksikut dialektor e krahinor të shqipës*, Tiranë, 1990, f. 310.

⁹ Shih p.sh., dy vargjet e fundit në këtë këngë popullore nga Ujemuja, Dibër:

Në sabah kënoi bilbili

Thanë se çeli tranafil;

Tranafil vesë-vesë,

Ja do t'marr, ja do t'vdes.

Në të folmen e Ujemujës njihet fjala *lazhdë* e jo *vesë*.

¹⁰ Ka tregime e edhe poezi me tema folklorike, të përpunuara letrarisht, që janë rikthyer në folklor të mirëfilltë.


shprehjes. Te frazeologjitë, ndryshimi është te motivimi i tyre i brendshëm (tipi *kosit në livadh të huaj / prashit në shpore të huaj / shin në lëmë të huaj; është thes i shpuar dikush dhe është shoshë e çjerrë dikush* etj.). Dhe te kjo ndryshueshmëria vjen vlerësimi leksikor dhe edhe trajtimi i tyre leksikografik.

d) Edhe nga emërtimet toponimike. Ato mund të jenë leksikalizime fragmentesh të ligjërimin bisedor (bisedor-krahinor), për të treguar vend, drejtim etj. (tipi *Djepsina* “vise që u ka rënë zjarri dikur”).

dh) Brenda konceptit ligjërim bisedor është fjalëformimi ekspresiv. Ekspresiviteti hyn në të gjitha pjesët e sistemit të ligjërimin bisedor. Ai rrok, siç dihet, kryesisht emra dhe mbiemra të përbërë ose të prejardhur me ndajshtesa me kuptim fjalëformues shprehës-emocionues.¹¹ Në folklorin poetik, p.sh., te fjala e prejardhur është ose sema me ngjyrim pëlqyes ose prapashtesa, gjithashtu, me ngjyrim pëlqyes; te fjala e përbërë është zakonisht, gjymtyra e dytë – zakonisht poetizëm popullor te këngët e dasmës e të dashurisë. Poetizmat janë gjithherë me konotacion pëlqyes e kësisoj, larg bisedorizmave.

Vijmë tek trajtimi leksikografik i leksikut, që na e sjell ligjërimi bisedor. Cilat nga njësitë ligjërimore bisedore e bisedore-krahinore mund të përfshiheshin në një fjalor kombëtar të gjuhës shqipe dhe cilat mund të shenjoheshin me shënimin leksikografik *bised.*?¹²

Siskema jonë qe:




Njësitë e grupit të parë (*fjalë të përdorimit të përgjithshëm*) përdoren, siç dihet, në shumë fusha të komunikimit ngaqë nuk e thyjnë normën letrare. Dhe kësisoj, nuk mund të shenjohen në fjalor me shënimin leksikografik *bised.*

Njësitë e grupit të dytë (*fjalë me përdorim të kufizuar*) janë ato të ligjërimin bisedor dhe ato të ligjërimin dialektor-krahinor.

Siskema jonë qe:

¹¹ Pse emra dhe mbiemra? Sepse emrat dhe mbiemrat janë “forma” të vlerësimit subjektiv.

¹² Zgjidhjet leksikografike që janë dhënë në Fjalorët kombëtarë të gjuhës së sotme shqipe (1980 / 1984 / 2002 / 2006 etj.) për njësi leksikore, semantike, fjalëformuese etj., që janë vjelë nga burime ligjërimore bisedore, na çojnë përgjithësisht te koncepte të drejta shkencore në punë të pasqyrimin të leksikut bisedor.



Interpretimi ynë i mëtejshëm është si më poshtë:

Fjalët e ligjërimit bisedor mund të jenë:

1) Njësi të leksikut bisedor profesional. Këto, si ato të grupit të parë (*fjalë me përdorim të përgjithshëm*), nuk e thyjnë normën letrare. Ato, vërtet përdoren në gjuhën e folur (bisedore) nga folës me interesa të përbashkëta profesionale, por për arsye të vlerës së tyre letrare potenciale¹³, mund të dalin nga sistemi “profesional” i “variantit bisedor”¹⁴ e të bëhen më pak bisedore a bisedore-krahinore.¹⁵ Edhe këto, përgjithësisht, nuk mund të shenjohen leksikografikisht me shënimin *bised*.

2. Njësi leksikore bisedore-etnografike, bisedore-etnobotanike, bisedore-etnozoologjike etj. Edhe për këto vlen gjykimi i mësipërm (1).

3. Njësi leksikore bisedore të ligjërimit të përditshëm të nivelit “të shkujdesur” ose krahinor fonetik, morfologjik, sintaksor¹⁶ (tipi *nashti* për *tashti / tani*; *paracion* për *operacion*, *paçim* për *mirupafshim*). Fjalori kombëtar i gjuhës së sotme shqipe nuk e ka për detyrë të merret me këtë ligjërim të përditshëm. Ky ligjërim i përditshëm është në opozicion me ligjërimin mirëfilli bisedor. Ai është pjesë e ligjërimit bisedor¹⁷, por – në anërrugë të tij, sepse është tej kufijve të gjuhës së njëzuar letrare. Në gjuhën e letërsisë artistike është mjet stilizimi. Ligjërimi i mirëfilltë bisedor, përkundrazi, është i stilit bisedor të gjuhës letrare. Dhe, meqë ky ligjërim i përditshëm dhe leksiku i tij është tej kufijve të gjuhës letrare, Fjalori kombëtar nuk merret me të.

¹³ Gjuhësia ka vërtetuar se grupe të ndryshme tematike leksikore kanë zhvillime të ndryshme krahinore. Sa më aktuale të jetë një veprimtari shoqërore dhe sa më shumë njerëz të përfshijë ajo, aq më shumë “detyrohet” njohja dhe përhapja e njësisë leksikore krahinore (në këtë rast – me vlerë të shtuar letrare potenciale) sepse lidhet me funksionin komunikues të gjuhës. Edhe Fjalori, që i shkon prapa gjuhës e zhvillimit të gjuhës, është “i detyruar” t’i pasqyrojë si njësi me vlerë letrare potenciale e pa shënimin “censurues” *bised*.

¹⁴ Si për arsye gjuhësore, ashtu edhe për arsye jashtëgjuhësore, aksh njësi leksikore krahinore mund të dalë nga kufijtë vendorë të së folmes falë përdorimit, kryesisht në një mjedis profesional e të shtegtojë më tej. Madje, mund të na vijë edhe zgjerimi territorial i tipareve gjuhësore-fjalëformuese të së folmes së dhënë.

¹⁵ Ka të tilla që kanë fituar statusin e termit.

¹⁶ Leksik bisedor i *jetës së përditshme* është koncept tjetër.

¹⁷ Skematikisht pjesa është kjo: Ligjërimi bisedor

Ligjërimi i përditshëm

4. Njësi leksikore bisedore të ligjërimin zhargonor (zakonisht, të të folmeve sociale). Gjykimi dhe vlerësimi është si për njësitë e ligjërimin të përditshëm (3): Fjalori nuk e ka për detyrë të merret me to.


5. Njësi leksikore të ligjërimin të thjeshtë. Janë të kufizuara stilistikisht. Kanë përmbajtje kuptimore ultësie. Janë fjalë (edhe forma fjalësh), togfjalësja, frazeologji etj. (p.sh., *kryederr*, *kryehu* etj.), që përdoren në komunikime ligjërimore shumë bisedore. (Në komunikime ligjërimore jobisedore përdoren baraspalës ose sinonime asnjëse, neutrale ose edhe me vlerësim pozitiv, pëlqyes). Janë fjalë etj. me kuptim fyes, sharës, përçmues, përbuzës. Janë mallkime e nëmë. Janë edhe fjalë me përmbajtje seksore etj. Ky lloj leksiku është karakteristik për folës të pakulturuar shoqërisht e gjuhësisht. Për arsye gjuhësore dhe jashtëgjuhësore janë, sigurisht njësi brenda kufirit të gjuhës letrare, dhe kësaj, nuk mund të mos jenë pjesë e Fjalorit kombëtar. Por, si njësi onomasiologjike, të kufizuara stilistikisht e me përmbajtje kuptimore ultësie, e meritojnë dhe e duan sigurisht shënjimin leksikografik *bised*. (= fjalë bisedore). Njëherësh, duan edhe shënime të tjera vlerësuese (onomasiologjike): *përçm.* (= përçmuese), *përb.* (= përbuzëse) etj. Të tilla fjalë (edhe forma fjalësh), togfjalësja, frazeologji e edhe fjalë të urta përdoren, siç u tha, në komunikime ligjërimore shumë bisedore. Njësitë asnjëse, neutrale janë – po e përsërisim baraspalësit, sinonimet në komunikime ligjërimore jobisedore. Shih e krahaso, p.sh., njësi të tilla në tekstin e mëposhtëm:

A VOTOHET ME DAJAK NË DORË?!

(Fejton)

Nashti që janë ndezur motorët për zgjedhje ..., janë ndezur edhe zagarët në stanin tim. U dhashë urdhër ... të zbytheshin. Vrava rradaken ... Ky ishte sebepi. Edhe unë, kur kam ndonjë axhele, u bëj nga një kartë ... Atë çast më zuri frika se mos haja edhe unë ndonjë hu. Për kë e ruani atë dreq vend? ... Ai që mbante atë vend, i ktheu patkonjtë nga dielli. Në atë han ligjin e bënte druri. Futa takëmet e mia në brucë e dola nga hyra. Koka më ziente si kazan. Atje të hiqnin kokn me gjithë feste ... Ligjin e bënte një polic burgaxhi.

6. Njësi leksikore të ligjërimin bisedor krahinor. Siskema IV që:



Për nëngrupin e parë – *fjalë krahinore me vlerë letrare potenciale* na vjen në ndihmë *teoria e leksikut popullor krahinor me vlerë letrare potenciale*.¹⁸ Edhe për të bërë përzgjedhjen tonë leksikografike për fjalësin në një fjalor, madje, edhe për shënimin *bised.* sipas parimeve e kriterëve shkencore.

Ato njësi leksikore, semantike, fjalëformuese etj., që sipas gjykimit leksikografik objektiv, janë me vlerë letrare potenciale, nuk mund të shenjohen me shënimin leksikografik *bised.* Shënimi *bised.* do ta pengonte ose do ta përngadalësonte rrugën (për të shkuar) te gjuha e njësuar letrare. Për arsye gjuhësore dhe jashtëgjuhësore, njësi të tilla popullore krahinore, si, *bubërroj* (1. *bubërrojnë*; 2. merrem me punë të vogla), *kërrudhë* (rudhë e madhe petku), *kërrudh*, (*i*, *e*) *kërrudhët*, *kërrkëllon* (*kërrkëllon* trari), *i* (*e*) *kërpudhtë* (*fytyrë e kërpudhtë / dhi e kërpudhtë*), *i* *lëmshkhtë* (*fytyrë e lëmshkhtë*), *i* *molltë* (në ngjyrë të mollës: *i verdhë i molltë*), *i* *ndorshëm* (që bën çdo punë, që i vjen ndoresh për çdo gjë / për një njeri), *tërthoj rrugën / edhe fig.*), *punëpabamë*, *punëpadukëm*, *thojpapremë*¹⁹, *klukem* (1. pula; 2. qaj me zë të mbytur), *lëvakem* (më vjen një si të fikët), *lëhordhem* (tund trupin për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve / zakonisht për një vajzë a grua), *përshtyj*, *përshtyhem*, *përlut*, *përlutem* (e folje të tjera me kuptim përforcues / me parashtesën *për-*), *shtypem* e *përshtypem* (= ngurroj për ta thënë diçka), *përlyhem* (me kuptimin «ngatërrohem në një punë a veprimtari të papëlqyeshme»), *putrrohem* (= rrëgjohem shumë), *perrisem* (më kapin perritë, bëhem me fiksime), *piskëllon* (nxjerr një zë të hollë si fishkëllimë / për pushkën kur del plumbi), *piskëllimë*, *kopshtnajë*, *kurtnajë* (kurt = oborr), *lamënajë* (= lëmënajë), *rrugënajë*²⁰ nuk mund të shenjohen me shënimin *bised.* As *gërranë* (në pyll ishte një grronë), *gufallë* (vajza hyni në gufallë të rrapit), *patosh / patush*, *parësi* (thirri mbreti gjithë parësinë), *shëmoj* (= dënes) e *shëmim* etj. Përveçse sjellin vlera pozitive individuale, ato janë pjesë e grupeve të caktuara tematiko-leksikore. Dhe njësi të grupeve të caktuara e edhe vetë grupet e caktuara tematike (p.sh., profesionalizmat) mund të mbërrijnë te gjuha standarde. Ka, siç dihet, rrugë, mjete e mekanizma për këtë. Jo vetëm ato fjalë (që shënojnë realie, nocione etj.) të panjohura për gjuhën e njësuar letrare (p.sh., *dyshimtar*), por edhe paralelet sinonimike (tipi *kalashtoj* për *përkëdhel / ledhatoj*), mund të shkojnë


¹⁸ A. Kostallari, “Parimet për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972, f. 14-18; J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor i shqipes*, Tiranë, 2001, f. 183-217; Shih edhe një punim tonin në “Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe”, Tiranë, 2015, f. 27-46; Shih edhe V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe 6*, Tiranë, 2021, f. 37-49.

¹⁹ Sigurisht, Fjalori kombëtar i modelizon njësitë leksikore krahinore sipas standardit.

²⁰ Shembujt janë nga *Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës / Qarku i Dibrës*, Tiranë, 2015.

më tej se e folmja ose se grupi i të folmeve. Ligjërimi bisedor letrar – gjegjësisht, vepra letrare artistike (ose edhe folklorike mbidialektore) – mund t'i çojë edhe më tej. Ku? Në gjuhën e njësuar letrare.²¹ Sigurisht, bashkë me modelin fjalëformues dhe mjetin fjalëformues. Kësisoj, bashkë me bashkëndikimin e nënsistemeve leksiko-semantike të të folmeve dhe ndikimin e gjuhës së njësuar letrare me normativitetin dhe normativizimin e saj, të tilla njësi dhe të tilla mjete e gjedhe fjalëformuese mund të fitojnë të drejtën e “qytetarisë” në gjuhën standarde.

Nga pikëpamja fjalëformuese, rasti klasik janë prapashtesat *-naj(ë)*, *- emë*, *-shëm* (te ndajfoljet etj.). Krahaso, p.sh., edhe kategoritë morfologjike të zvogëlimit (tipi *zogth*) dhe kategorinë morfologjike të zmadhimit (tipi *valomë*, *zezomë*, *palomë*: *palomë dushku*). Rast tjetër mund të konsiderohen mbiemrat e prejardhur prejemërorë me parashtesën *pa-* (i *padorë*, i *pafytyrë*, i *pagojë*, i *pakrye*, i *pakokë*, i *pamend*, i *pakrah*, i *pazë*, i *pander*, i *pashok*, e *pashoqe* (edhe: e *pakundshoqe*), i *pashtëpi*, i *pafamilje*, i *pafëmijë*, i *pababë*, i *panënë*, i *pavëlla*, i *pamatër*, i *pakohë*²² etj. dhe mbiemrat e prejardhur me infiksin *pa*²³ (*borxhpalarë*, *flokëpakrehur*, *fytyrëpalarë*, *thonjpaperë*, *punëpabërë*, *fjalëpathënë*, *zëpaqitur*, *sypafjetur*, *jetëpagëzuar* etj.).²⁴




²² Formimet *i pajetë*, *i papunë*, *i paturp*, *i pagjak*, *i pashpresë* etj. janë në Fjalorët kombëtarë të gjuhës shqipe. Mund të jenë pjesë e Fjalorit edhe: *i pakohë*, *i pakrye*, *i pakokë*, *i pababë*, *i panënë*, *i pavëlla* (*Kush asht i pavëlla*, / *Kurrkush hatrin nuk ia ka*. / *Kr. pop.*), *i pamatër*, *i pander*, *i pasoj* (*burrë i pasoj* – jofisnik). Janë, jo vetëm formime që plotësojnë qeliza të zbrazëta në strukturën e gjuhës standarde, por kanë në njëfarë mënyre edhe ngjyrim vlerësues-emocional. Dhe modeli fjalëformues vetëm zgjatet.

²³ Të gjitha formimet janë shprehëse - emocionuese.

²⁴ Siç dihet, format e gjuhës nuk janë sisteme të mbyllura. Ato bashkëveprojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet shtresës së përgjithshme të leksikut, që është në themel të gjuhës së përbashkët kombëtare. Meqë kjo shtresë e përgjithshme e leksikut është në themel të gjuhës së përbashkët kombëtare, njësitë leksikore që hyjnë në të, janë asnjënjë, domethënë, mund të përdoren në të gjitha format e në të gjitha stilet e gjuhës, pa krijuar disharmoni në tekst. Por, asnjënjësia e leksikut duhet parë sipas klasave funksionale-stilistike e ekspresivo-stilistike; ndryshe, mund të na dilnin shumë sinonime absolute. Pra, duhen dalluar sinonimet që hyjnë në marrëdhënie sinonimike në varësi të formave gjuhësore ekzistuese.

SUMMARY

On Colloquial Speech and Its Lexicographical Labelling

As it is seen from the diagram, colloquial speech is ranked amidst the standard language and regional speeches. And it means that it is under the impact of both the standard language and dialectical-regional speech. For many reasons – more and more under the impact of the standard. And thus, the circle of speakers having literary their colloquial speech, is being enlarged. Finally, it means that the lexicographical colloquial label “*bised.*” (= colloquial) could not be applied quite freely.